

demost*ti*



Nr 300; 25.05.2018

# DEMOS-TI FESTON



# GAZETA FËMIJËSH

## NE JEMI PJESË E VENDIMMARRJES

ENIS (10), VIOLA (10), ERLIND (11), BLERONA (11), BLEON (11), ALONA (10)



**Shteti ynë Kosova, është bërë shtet i pavarur dhe demokratik në vitin 2008. Që nga ajo kohë, ne qytetarët kemi shumë përfitime të cilat e përmbushin jetën tonë. Njëra nga këto gjërat e mira është pranimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve**


Ne si fëmijë kosovarë, i kemi të drejtat tona, pasi që jetojmë në një shtet demokratik. Këto të drejta, neve na mundësohen nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Kjo Konventë hyri në fuqi në vitin 1990. Prej asaj kohe çdo shtet i cili e ka pranuar këtë Konventë, i gëzon fëmijët me shumë të drejta.

Ne kemi shumë të drejta. Si fëmijë, ne kemi të drejtë të kemi një familje, të argëtohem, të shkollohem, etj. Një e drejtë tjetër që ne e posedojmë është e drejta për vendimmarrje. Këtë të drejtë dëshirojmë ta sqarojmë me një shembull. Me mësuesen tonë jemi shumë të lidhur dhe ajo i respekton kërkesat tona. Këtë gjysëmvjetor, ne nxënësit kemi vendosur që të mos i

nënshtrohemi testit me shkrim për t'u notuar, por kemi vendosur që secili t'i zgjedh nga tri njësi mësimore dhe të pyetemi gojarisht për to.

Një shembull tjetër e kemi me shoqen tonë Alonën, e cila ka jetuar në Gjermani për dy vjet. Ajo atje nuk është ndier aspak e diskriminuar nga bashkëmoshtarët e saj gjerman. Me këtë shembull ne dëshirojmë të themi se Konventa për të Drejtat e Fëmijëve na mbron neve fëmijëve nga çdo lloj diskriminimi.

Ne frymojmë lirshëm dhe kemi shumë të drejta duke e falenderuar shtetin tonë i cili e ka pranuar Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. E neve na mbetet vetëm t'i shfrytëzojmë dhe t'i respektojmë këto të drejta.



Lumturia jonë si fëmijë demokratë



Jemi të buzëqeshur, sepse kemi të drejta

## ZGJEDHJET DHE PROCESI ZGJEDHOR

OLSA (11), ALORIN (11), ADEA (10), OMER (11), BESNIK (10), ELVIS (11), MENDEREZ (11)



# ZGJEDHJE

### Ekziston një dallim mes zgjedhjeve dhe procesit zgjedhor. Mësojeni se cili është ky dallim

Atëherë, ne jemi të lumtur që ju po vazhdoni ta lexoni artikullin tonë. Siç edhe ju treguam më lart, sot e kuptuam edhe ne dallimin mes zgjedhjeve dhe procesit zgjedhor. Këtë dallim do t'ua tregojmë edhe juve.

Ne si nxënës kemi shumë mundësi për të zgjedhur. Për shembull, na ofrohet mundësia të zgjedhim lëndën e preferuar, instrumentin e preferuar apo edhe sportin që duam ta ushtrojmë. Për më tepër, ne mund të zgjedhim edhe shokun apo shoqen më të mirë.

Mirëpo, një proces shumë i rëndësishëm demokratik për të gjithë qytetarët e një vendi është procesi zgjedhor. Kjo për shkak se në këtë proces ne i zgjedhim personat, të cilët do të përfaqësojnë dhe udhëheqin shtetin tonë. Këta persona janë aq të rëndësishëm, sa nuk mund të thuhet. Nëse ata punojnë me përkushtim,

ne do të mund të kemi jetë më të mirë.

Për të marrë pjesë në këtë proces duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Ky është dallimi i parë mes zgjedhjeve të përditshme dhe procesit zgjedhor.

Dallimi tjetër është se zgjedhja jonë në procesin zgjedhor ndikon edhe në jetën e qytetarëve të tjerë. Kurse, zgjedhja e një akulllojeje me shije vanilje apo çokolate, nuk ndikon në jetën e askujt tjetër, përveç tonës. Prandaj, përgjegjësia jonë është më e madhe në procesin zgjedhor.

Në vendin tonë ne kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet qendrore dhe ato komunale. Në zgjedhjet qendrore ne qytetarët i zgjedhim përfaqësuesit tanë, të cilët janë deputetët. Ndërkaq, në zgjedhjet komunale i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Asnjëherë mos harroni se vota është e drejtë dhe përgjegjësi e jona, si qytetarë.



Këtu jemi duke punuar në artikullin tonë




Sepse kemi dëshirë të mësojmë për zgjedhjet





# QYTETARËT AKTIV UDHËHEQIN KËTU

ARTI (11), AMAR (11), SYARTA (11), HARISA (11) MEDINA (11), FIONA (14)



**Lexues të dashur, sipas nesh është shumë e rëndësishme të merrni njohuri për qytetarinë aktive. Këto njohuri do t'iu duhen në jetën tuaj. Andaj, lexojeni artikullin tonë**

Në fillim të artikullit dëshirojmë të tregojmë disa fakte për qytetarët e Kosovës. Në Kosovë jetojnë përafërsisht 2 milionë banorë, të cilët janë qytetarë të Kosovës. Këta qytetarë të Kosovës kanë shumë etni, siç janë: shqiptarë, romë, serbë, ashkalinjë, turq, egjiptianë, boshnjakë dhe goranë. Edhe pse disa nga këta nuk janë shqiptarë, të gjithë janë të regjistruar në Regjistrin Civil. Po ashtu, këta qytetarë quhen qytetarë të Kosovës, sepse jetojnë brenda kufijve të territorit të saj.

Ne mendojmë se në një vend të tillë ku ka diversitet etnik dhe respektim të elementeve të demokracisë duhet të ketë ligje, të cilat duhet të respektohen nga të gjithë. Nëse ndonjë qytetar nuk respekton ligjet e vendit, ai/ajo do të ndëshkohet për veprën e bërë, sipas ligjeve në fuqi. Ne kemi shumë ligje, si për shembull: të ruajmë ambientin, të mos hedhim mbeturina në tokë, të përfundojmë shkollimin deri në klasën e IX-të, të mos shkelim të drejtat e askujt, etj.

Qytetarët aktiv janë ata të cilat shkollohen në shkollat fillore, pastaj ata shkojnë në shkollat e mesme e në universitete, ku ata diturohen për profesionin që ata dëshirojnë ta ushtrojnë në të ardhmen. Qytetarët pasi të arrijnë moshën 18 vjeçare kanë të drejtë edhe të votojnë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre. Për të mirën e tyre dhe të tjerëve, qytetarët kanë obligim edhe t'i paguajnë taksat.

Kur për ndonjë çështje të caktuar qytetarët aktiv kanë ankesa, ata shkojnë tek komuna përkatëse dhe kështu ndihmojnë zhvillimin e qytetit apo fshatit të tyre. Ka qytetarë që bëjnë edhe punë vullnetare si: mbledhin mbeturinat apo ftojnë qytetarët e tjerë për të nënshkruar peticione të ndryshme.

Në këtë pjesë të artikullit duam të tregojmë një shembull që më ka ndodhur mua në jetën time, e që më bën qytetar aktiv. Unë po luaja një videolojë të quajtur „Habbon“. Duke vëzhguar versionin e ri që pronari i lojës kishte futur, papritmas pashë se shkruante “Aplikim për t’u bërë Staf i lojës“. Unë mendova të aplikoj vetëm ta provoj fatin tim. Të nesërmen pashë se llogaria ime ishte hapur dhe emri im ishte ndryshuar në “MOD-Arti“. Kjo do të thotë që jam bërë një moderator dhe tani kam një detyrë të re. Detyra ime është t’iu ndihmojë personave të cilët kanë nevojë për t’i mësuar rregullat dhe udhëzimet e lojës. Faleminderit për vëmendjen tuaj, të dashur lexues. Ju urojmë gjithë të mirat.



Gazetarët e vegjël, por shumë punëtorë





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Thimi Mitko“  
Klasa: V-2  
Vendi: Gjilan